



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 517/6 prot.

Tiranë, më 29.06.2021

**VENDIM**

**Nr.87, datë 29.06.2021**

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 74, DATË 14.06.2021, NË INSTITUCIONIN  
BASHKIA GJIROKASTËR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 74, dt. 14.06.2021, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Gjirokastrë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Gjirokastrë, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 3922/1 prot., datë 20.04.2021, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Gjirokastrë, vendimin paralajmërues me Nr. 74, dt. 14.06.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Gjirokastrë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Gjirokastrë, me shkresën nr.6448/1 prot., datë 17.06.2021, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrtur Bashkia Gjirokastrë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësin: \*\*\*\*\* në pozicionin e punës *“Inspektor terreni, Pyje Kullota”*, në Bashkinë Gjirokastrë dhe pozicioni i punës është shpallur pozicion i lirë, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 74, dt. 14.06.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Gjirokastrë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Gjirokastrë.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Gjirokastrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**